

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE LAVATRIÇE, MAKINË THARËSE RROBASH,TELEVIZOR, FRIGORIFER, BOLIERË,TAVOLINË HEKUROSIJE, HEKUR HEKUROSIJE, APARAT FOTOGRAFIK PROFESIONAL”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 32324100-1: 39713200-5: 39711130-9: 42515000-9: 39713510-1

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 3 479 790 (tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; neni 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlloritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar është kërkuar edhe vlera e xhiros vjetore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar edhe vlera e kërkuar për furnizime të ngjashme do të vendoset konform kësaj dispozite ligjore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë **minimalisht 1 (një) mjet për transport mallrash**, i cili mund të jenë në pronësi/qera/huapërdorje, si më poshtë:

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetet e këkuara sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi Pronesi/qera/huapërdorje
1			

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik i vlefshëm, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik i vlefshëm, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

Shënim: Kriteri 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkua më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimin.

Nisur nga sasia, përmasat e mallrave objekt prokurimi si dhe vendodhja e objekteve hotel i AFA dhe hotel i QAPU Bunavi, si dhe në godina e Rektoratit, Fakultetit, Bibliotekës etj, objekte në pronësi të Akademisë së Forcave të Armatosura, ku do të furnizohen dhe vendosen, montohen

mallrat objekt prokurimi, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë edhe një mjet të përshtatshëm për transportin e mallrave në destinacionin e kërkuar, me qëllim relizimin në kohë të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës për ralizimin e kontratës objekt prokurimi, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Specialist hidraulik	1
Shofer	1
Total	2

Për specialistët hidraulik të paraqitet

- Dëshmi kualifikimi profesional/certifikate, lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) te licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh", te ndryshuar.
- Kontratë pune të vlefshme.

Për punonjësin shofer të paraqitet:

- Kontratë pune të vlefshme.
- Leje drejtimi përkatëse e vlefshme

Shenim 1: Punonjësit e sipërkërkuar jo detyrimisht duhet të jenë përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik, ata mund të kontraktohet enkas për realizimin e kësaj procedure, vërtetuar me kontratën përkatëse e vlefshme për aftin e realizimit te objektit te prokurimit dhe dokumentet e tjera për secilin punonjës, sipas kriterit nr.3

Shënim: Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. P" i ndryshuar; VKM nr. 514, date 20.09.2017 "Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)"; Ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Duke vlerësuar faktin që furnizimi me mallrat objekt prokurimi përfshin edhe vendosjen, montimin e mallrave si bolier në objektet hotel i AFA dhe hotel i QAPU Bunavi, si dhe në godina e Rektoratit, Fakultetit, Bibliotekës etj, objekte në pronësi të Akademisë së Forcave të Armatosura, autoriteti

kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që, me qëllim garantimin e përmbushjes me sukses të kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin e kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) specialist hidraulik që lidhet drejtëpërdrejtë me furnizim/vendosjen dhe montimin e bolierve.
- 1 (një)shofer, i cili do të realizojë transportin e mallrave objekt prokurimi në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor Akademia e Forcave të Armatosura, i cili duhet të jetë i pajisur me lejen e drejtimit përkatëse.

Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektet ku do të kryhet furnizimi, vendosja/ monitimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimit të mallit.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqese katalogun ose fragmente të katalogut të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi (dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip) ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa e përcaktuara më sipër që lidhen me paraqitjen e katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve, shërbejnë që të bëhet krahasimi i pajtueshmerisë së mallrave që do të ofrohen me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara. Me anë të këtij krahasimi, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST.

Duke vlerësuar objektin e veprimtarisë së Akademisë së Forcave të Armatosura, nëpërmjet kriterit të mesipërm krijohet bindja dhe siguria që mallrat me të cilët do të furnizohen do të jenë sipas standarteve të kërkuara, pasi cilësia e mallrave dhe realizimi në kohë i kontratave, që do të prokurohen është shumë e rëndësishme për efikasitetin dhe mbarëvajtjen e punës për AFA.

5. Operarori ekonomik duhet të paraqesë një dekaltratë për garancinë e mallrave objekt prokurimi si më poshtë:

-Afati i garancisë do të jëtë sipas afatit të përcaktuar në shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*”, për secilin nga mallrat objekt prokurimi.

-Mallrat objekt prokurimi do të shoqërohen më fletë garancie në momentin e dorëzimit të tyre pranë Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se mallrat e ofruara janë cilësore dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekte që vijnë si rrjedhë e prodhimit apo montimit të tyre.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë furnizimin/vendosjen dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune pranë Autoriteteve Kontraktore përfutuese për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 06.09.2024; Ora: 11:00; Vendi: www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.